



Drejtoria për Arsim në Deçan

Nr.07-Zyrtarisht

Datë:15.11.2018

Deçan

Në bazë të kërkesave të shkollave të komunës së Deçanit, konform dispozitave të nenit 8 pika 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, si dhe nenit 5 pika (c) të Ligjit nr.03/L-068 për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, nenit 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e Procedurave të konkursit në sektorin publik, Drejtoria për Arsim në Deçan, shpall :

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në këto Institucione edukative Arsimore aftësuese në komunën e Deçanit.

I. SH.F.M.U. “ Faik Konica “ në Ratish.

1. Një Mësues Klase me kohë të caktuar ,
2. Një mësuesdhënës të Gjuhës dhe Letërsisë Angleze me kohë të caktuar.
3. Një mësuesdhënës të lëndës së matematikës për 15 orë mësimi në javë me kohë të caktuar.

Dokumentacioni i kërkuar për konkurrim :

- Formulari i aplikimit merret në DKA –Deçan,
- Rezumeja personale (CV),
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë) kopje,
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat) të noterizuara të noteri, certifikata në vend të diplomës mos të jenë më të vjetra se gjashtë muaj nga data e diplomimit,
- Certifikata që nuk jeni nën hetime
- Dëshmi të përvojës në arsim (nëse ka), dhe
- Trajnimet të akredituara nga MASHT (nëse ka).

KUSHTET

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji nr.02/L-52, Ligji nr.03/L-068 dhe Ligji nr.04/L138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHT-it UA nr.17/2009 si dhe UA nr.10/2018 dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik..

Kriteret e Kualifikimit për Mësues Klase :

- Fakulteti i Edukimit programi Fillor,
- Fakulteti i Mësuesisë.

Kriteret e Kualifikimit për Gjuhë dhe Letërsi Angleze.

- Niveli Master arsimor –Fakulteti i Edukimit (300 ECTS),
- Sistemi katër vjeçar.
- Baçelor katërvjeçar-240 ECTS.:

Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do ti nënshtrohen testit me shkrim .Testi me shkrim në maksimum tërheqë 100 pikë apo deri në 50% të vlerësimit përfundimtar.

Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjidhen në pozitat e lartcëkura.

Për intervistë do të ftohen ata kandidat të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të lartcekura.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test ,intervistë si dhe orari i intervistave publikohet në ueb fagen e komunës së Deçanit <https://kk.rks-gov.net/decan/>.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit. 16.11.2018 e deri më datën dt.30..11.2018.


 HYPERMEDIJA BEOGRAD
 REPUBLIKA EKSDOBER - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E BEGRADIT - GEMEINSCHAFT BEGRAD - BUDAPEST MUNICIPALITY
 No: Dr. Ansimi Mr. Prot: 35588
 From: _____ Dr. Prot: _____
 Nr. Ispisane: _____ Data: _____
 Se Stranic: 07 Datum: 15.11.18
 na Pages: _____ Date: _____
 BEGRAD BEGRAD

Qazim Dreqin

Drejtori,

Qazim Maloku